



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Kuvendi i Kryeqytetit
Skupstina Glavnog Grada-Municipality of Prishtina

E K S T R A K T

i mbledhjes së katërt të Komitetit për Komunitete, mbajtur më 25.4.2023, me fillim në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: Mirsada Behluli, Arton Brahim, Elmira Nikçi - Rexha, Nenad Miladinovic, Kimeta Shok, Oktay Kurtesh, Adnan Ajeti.

Munguan: Trieria Kasumi Berisha, Faton Marolli.

Në mbledhje morën pjesë edhe: Fadil Aliu, udhëheqës i Zyrës së personelit dhe Sllavica Stolic.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi kryesuesja e Komitetit për Komunitete znj. Mirsada Behluli me këtë:

R E N D I T E

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KK-së;
2. Ftesë për drejtoreshën e Drejtorisë së Arsimit, znj. Besianë Musmurati;
3. Ftesë për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike z. Ilirik Musliu, diskutim lidhur me sfidat në regjionet ku jetojnë komunitetet joshumicë, koordinimi i përbashkët i aktiviteteve gjatë vitit 2023;
4. Ftesë për udhëheqësin e personelit z. Fadil Aliu, lidhur me respektimin e të drejtave të komuniteteve jo shumicë, punësimin dhe përfaqësimin e tyre;
5. Raporti i ZKKK-së për muajin mars 2023;
6. Raportimi i përfaqësuesve të komuniteteve jo shumicë lidhur me gjendjen e sigurisë në bashkësitë e tyre;
7. Të ndryshme.

Njëzëri u miratua rendi i ditës.

Pika e parë

Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KK-së
Njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Pika e dytë

Ftesë për drejtoreshën e Drejtorisë së Arsimit, znj. Besianë Musmurati.
Kjo pikë e rendit të ditës është shtyrë për njërën nga takimet e radhës.

Pika e tretë

Ftesë për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike z. Ilirik Musliu, diskutim lidhur me sfidat në regjionet ku jetojnë komunitetet jo shumicë, koordinimi i përbashkët i aktiviteteve gjatë vitit 2023.

Po ashtu edhe kjo pikë e rendit të ditës është shtyrë për njërën nga takimet e radhës.

Pika e katërt

Ftesë për udhëheqësin e personelit z. Fadil Aliu, lidhur me respektimin e të drejtave të komuniteteve jo shumicë, punësimin dhe përfaqësimin e tyre.

Fadil Aliu - sa i përket punësimin të komuniteteve joshumicë në Komunën e Prishtinës, tha se nga 557 shërbyes civilë, dhjetë prej tyre janë të komuniteteve joshumicë, ndërsa tek institucionet vartëse që janë kryesisht të shërbimit publik, janë gjashtëdhjetë e nëntë (69), ku prej tyre tre janë të komuniteteve joshumicë. Tutje tha se po ashtu kam kërkuar edhe prej DKA-së, e cila në institucionet shkollore dhe parashkollore ka 3170 punëtorë, të shikojë dhe të na informojë se sa prej tyre janë të komuniteteve joshumicë, në ç' rast m'i kanë dërguar të dhënat, ku prej 3170 punëtorëve, 38 prej tyre janë të komunitetit joshumicë, kurse sa i përket konkurseve tha se në secilin konkurs që e shpallim në fund të konkursit ne i lutemi sidomos komunitetit joshumicë të marrë pjesë nëpër konkurse, sepse në kushte të barabarta atyre iu jepet prioritet. Në fund tha se tash e 13 muaj jam në pozitën aktuale edhe i kam zhvilluar mbi 80 konkurse në Komunë të Prishtinës, ku ende asnjë pjesëtar i komuniteteve joshumicë nuk ka aplikuar, prandaj apeloj tek të gjithë përfaqësuesit e komuniteteve joshumicë që të aplikojnë sa më shumë në konkurset të cilat shpallen nga Komuna e Prishtinës.

Kimeta Shok - sa i përket konkursit tha se tani ka qenë një konkurs ku një shoqe e imja nga komuniteti boshnjak ka dashur të konkurrojë. Ajo ka provuar të konkurrojë, mirëpo nuk ka mundur të hyjë nuk e di çfarë është sistemi dhe njëherazi kam provuar edhe unë vetë, por nuk kam mundur të kyçem.

Fadil Aliu - duke u ndërlidhur në diskutimin e znj. Shok, tha se siç e ceka edhe në fillim ky sistem menaxhohet nga Ministria e Punëve të Brendshme, e përdorin të gjitha Komunitat e Kosovës, edhe procedurat për të aplikuar të gjitha janë online dhe nuk ka fizike asgjë. Ai njëherazi të pranishmëve iu dha sqarime se si mund të aplikojnë dhe të konkurrojnë online. Në mes tjerash ai tha se kur kandidatët kanë probleme në rrethana të tilla, ata duhet të vijnë tek burimet njerëzore d.m.th tek ne, ku ne zakonisht bëjmë përpjekje maksimale që t'i ndihmojmë çdo pale, dhe në rrethanat kur edhe nuk mundemi t'ju ndihmojmë pasi që ne nuk

e menaxhojmë sistemin, atëherë ne kandidatëve shpeshherë ju sugjerojmë që të shkojnë tek kati përdhe, në objektin e ish-Rilindjes, ku është e vendosur vetë Ministria e Punëve të Brendshme dhe ata ju dalin në ndihmë pasi që ne nuk e menaxhojmë këtë sistem, por e menaxhon ministria.

Oktay Kurtesh - shtroi pyetje se sa punëtorë të komunitetit turk ka që punojnë në Komunën e Prishtinës,

ndërsa sa i përket konkursit që e cekët se nuk po konkurrojnë, tha se po konkurrojnë, por ndoshta nuk keni mundur t'i vëreni nga emrat.

Fadil Aliu - sa i përket pyetjes së z. Kurtesh, tha se nga komuniteti turk në Komunën e Prishtinës janë dy punëtorë, ndërsa sa i përket konkursit tha se ne kryesisht e shikojmë se a i plotësojnë kriteret e nuk i shikojmë nga aspekti i nacionalitetit. Pastaj tha se pak vërehen kur janë të nacionaliteteve tjera dhe mundohemi me e mbajt njëfarë statistike, mirëpo aplikimi është jo i kënaqshëm për mua sepse numri është shumë i vogël.

Ai në vazhdim tha se tash e kemi pasur një kandidat nga komuniteti turk, i cili nuk e ka kaluar testin në ministri edhe ka bërë ankesë tek ne, duke kërkuar që testi me qenë në gjuhën turke sepse nuk e ka kuptuar siç duhet. Në fund tha se problemi është që në Komunën e Prishtinës gjuhë zyrtare janë gjuha shqipe dhe gjuha serbe edhe nuk mundet me ligj testi me qenë në asnjë gjuhë tjetër.

Mirsada Behluli - shtroi pyetje lidhur me fëmijët e martesave të përziera, se a kanë ata fëmijë ndonjë përkrahje lidhur me punësimin në krahasim me komunitetet tjera, ku perfekt i dinë të dy gjuhët dhe mund të shërbejnë shumë për të gjitha komunitetet joshumicë si p.sh tek konkurset.

Fadil Aliu - duke iu përgjigjur znj. Behluli tha edhe më herët thash se ne kryesisht e shikojmë se a i plotësojnë kriteret e nuk i shikojmë nga aspekti i nacionalitetit, ndërsa sa i përket njohjes së gjuhëve sidomos atyre zyrtare tha se është përparësi edhe llogaritjet prej komisionit kur bëhet vlerësimi i intervistës i japin pikë shtesë.

Nenad Miladinovic - tha se unë jam përfaqësues i komunitetit serb dhe në territorin e Komunës së Prishtinës jetojnë diku 650 serbë, edhe ajo çka është e sigurt e di se asnjë nuk është i punësuar në shërbimet publike të Komunës së Prishtinës. Tutje ai pyeti se a e njeh ligji punësimin e komuniteteve joshumicë, si dhe a ka ndonjë kuotë për punësimin e komuniteteve joshumicë në Komunën e Prishtinës.

Fadil Aliu - duke u përgjigjur në pyetjen e z. Miladinoviq tha se po ekziston kuota që është deri në 5%. Ai njëheras tha se kur të bëhet regjistrimi i popullsisë në muajin shtator, do e definojë më saktë përqindjen se sa duhet me qenë të komuniteteve. Në vazhdim ai tha se kur jemi duke folur për 3-5%, jam duke folur për obligative, por nuk do të thotë se nuk mund të kalohet kjo.

Nenad Miladinovic - Ai mes tjerash shtroi çështjen e disa qytetarëve të komunitetit serb se kanë problem nëpër sportele pasi që nuk ka dokumente për aplikim në gjuhën serbe, qoftë për dokumente personale apo diçka tjetër, pasi që ka shumë prej tyre që nuk e dinë gjuhën shqipe.

Pastaj tha se me sa e di unë ishte dashur të ketë dokumentacione në të dy gjuhët për arsye që ta kenë më lehtë të aplikojnë qoftë për dokumente personale, kërkesa, ankesa etj.

Fadil Aliu - tha, sa i përket kësaj të fundit, kisha me i lutur Artonin dhe Lindën që në bashkëpunim me Luljetën shefen e Sektorit të Kuvendit dhe drejtorin, që të verifikojnë këtë se a është e vërtetë kjo që po e thotë Nenadi, pasi që sa e di unë shumica e dokumenteve janë shqip dhe serbisht. Pra nëse është ashtu siç po e thotë Nenadi duhet të ndërmerren masa për ta rregulluar këtë çështje.

Slavica Stolic - shtroi çështjen e dokumenteve qoftë të ndonjë vendimi që e pranon apo qoftë të ndonjë dokumenti tjetër nuk e pranon në gjuhën serbe.

Fadil Aliu - duke iu përgjigjur znj. Stolic tha se me sa kam dijeni unë, të gjitha vendimet bëhen në gjuhën shqipe me përjashtim të atyre kur jeni pjesë e komisionit apo kur vetë pala është e komunitetit tjetër që nëse i jepet në gjuhën shqipe duhet të kërkojë në gjuhën serbe pasi që nuk e kupton gjuhën shqipe. Prandaj komuna e ka obligim për ta përkthyer dhe për t'jua dhënë në afatin shumë të shkurtë.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës pas shumë diskutimesh, sugjerimesh u konstatua që të verifikohen dokumentet në sportelet se a janë në dy gjuhët zyrtare, po që se nuk janë, të shikohet, të intervenohet dhe të sigurohen në të dy gjuhët, që palët e komunitetit joshumicë të mos kenë probleme të tilla.

Pika e pestë

Raporti i ZKKK-së për muajin mars 2023

Slavica Stolic - në pika të shkurta, të pranishmit i informoi lidhur me punën e ZKKK-së për muajin mars 2023.

Pika e gjashtë

Raportimi i përfaqësuesve të komuniteteve joshumicë lidhur me gjendjen e sigurisë në bashkësitë e tyre

Adnan Ajeti - të pranishmit i informoi lidhur me një vjedhje në një shtëpi, lagjen e tij ku policia është e njoftuar, si dhe pas dy ditëve e kanë zënë hajnin dhe e kanë lëshuar. Ai në vazhdim tha se para disa ditëve kanë hyrë edhe tek unë, prandaj kisha me ju lutur që mundësisht të bisedohet me policinë që të patrollojnë ditë dhe natë në atë pjesë sepse jemi të rrezikuar nga hajnat.

Pika e shtatë

Të ndryshme

Kimeta Shok - shtroi pyetje pse nuk po na paguhen mëditjet.

Arton Brahimi - duke iu përgjigjur znj. Shok tha se puna e pagesave është shkak i Ligjit të pagave pasi që nuk ka asgjë me shkrim se sa do të bëhet pagesa e komiteteve.

Pas shumë diskutimesh, sugjerimesh dhe propozimesh Komiteti për Komunitete në mbledhjen e mbajtur më 25.4.2023, nga ana e përfaqësuesve të komuniteteve joshumicë pati vërejtje se aplikimi i dygjuhësisë në Komunën e Prishtinës nuk është në nivel të lakmueshëm, ndërsa vërejtja tjetër është për drejtorët e disa drejtorive edhe pse materialin e marrin shtatë (7) ditë para mbledhjes, nuk i përgjigjen ftesës, as nuk dërgojnë ndonjë zyrtar kompetent që të marrë pjesë në mbledhje.

Në mbledhjen e mbajtur të Komitetit për Komunitete, në bazë të diskutimeve u nxorën këto:

REKOMANDIME

1. Të ftohet drejtoresha e Drejtorisë së Arsimit, znj. Besianë Musmurati, (po që se drejtoresha nuk ka mundësi të vijë, të dërgojë zyrtarin kompetent).
2. Të ftohet drejtoresha e Drejtorisë së Mirëqenies Sociale, znj. Adelinë Sahiti, të na informojë lidhur me numrin e rasteve sociale nga radha e komuniteteve joshumicë.
3. Të ftohet zyrtarja për barazi gjinore - Premtime Preniqi, të na raportojë lidhur me sfidat dhe projektet për vitin 2023.

Procesmbajtësja
Lendita Spahija

Kryesuesja e Komitetit
Dr. Mirsada Behluli

M. Behluli

